



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 828/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Sejdi Sllamniku kandidat për kuvendin komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar apeli i Sejdi Sllamniku kandidat për kuvendin komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Fushë Kosovë për vendvotimet 0904E/02D; 0904E/01R; 0902E/03R; 0906E/01D

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 09:25, ka pranuar një apel nga Sejdi Sllamniku kandidat për kuvendin komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Fushë Kosovë në të cilën pretendon se nga rezultatet përfundimtare të KQZ-së ka më pak vota dhe se i mungojnë votat e familjarëve të tij nga vendvotimet 0904E/02D; 0904E/01R; 0902E/03R; 0906E/01D

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me ato për të cilën pretendon pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Fushë Kosovë për vendvotimet e larcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*

Nga sa u tha me sipër e ne mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.828/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.